



This project is funded
by the European Union



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



PËRSE PARTITË E REJA POLITIKE GJEJNË VËSHTIRËSI PËR TË PATUR SUKSES NË SISTEMIN POLITIK SHQIPTAR?

Nga Vasilika LASKA

Sistemi partiak mund të përkufizohet si një strukturë ku ndodh konkurrimi dhe bashkëpunimi ndërmjet partive politike (Lipse & Rokhan 1967). "Ekzistenca e partive politike është jetësore për funksionimin e demokracisë" (Bufi, 2010:23). Partitë janë lidhje e lirë e bashkëmendimtarëve, të cilët krijojnë propozimet programore për zgjidhjen e problemeve dhe kandidojnë anëtarët e saj për mandatet e parlamentit dhe administratës shtetërore, që pas suksesit në zgjedhje në ato institucione të realizojnë programet e tyre. Sistemi partiak ka ndryshuar shpesh, kjo edhe në varësi të sistemeve zgjedhore të cilat janë aplikuar në Shqipëri. Kemi pasur sistemin njëpartiak, dypartiak dhe sistemi i sotëm multipartiak. Por edhe sepse kanë lindur parti të reja përgjatë viteve të ndryshme ajo që është vënë re është jetëgjatësia e shkurtër e tyre. Partitë e reja janë gjetur në vështirësi për të pasur sukses në jetën politike në Shqipëri. Pikërisht ky punim ka si synim të analizojë arsyet se përse këto parti të reja kanë pasur këto vështirësi për të pasur sukses.

Elita Politike e pandryshuar!

Së pari problemi i mosfunksionimit të partive të reja në sistemin partiak në Shqipëri qëndron tek elita politike ekzistuese. Akoma dhe sot pasi kanë kaluar tridhjetë vite tranzicion politik që nga rënia e komunizmit atij sistemi të egër e të izoluar kemi po të njëjtit individë, kemi po të njëjtat elita politike, janë akoma po të njëjtat parti politike që zotërojnë sistemin partiak dhe politik në Shqipëri. Në Shqipëri nuk ka ndodhur një pastrim i sistemit politik nga figurat e hershme të komunizmit siç ka ndodhur në vendet e tjera të cilat kanë përjetuar po të njëjtin sistem komunist. Në shtete si Polonia, Hungaria apo Çekosllovakia pas rënies së sistemit diktatorial dhe vendosjes së sistemit demokratik elitat politike të vjetra kanë ikur së bashku me

Fituese në konkursin me ese "Mbi pikëpamjet e të rinjve mbi partitë politike dhe rolin e tyre në promovimin e demokracisë në Shqipëri. Realizuar në kuadër të projektit "Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen", i cili po jetësohet nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe Civil Rights Defenders (CRD), me mbështetjen e Bashkimit Europian.

sistemin e vjetër dhe ato janë ndryshuar me elita të reja, me ide dhe vizione demokratike ndërkohë që në Shqipëri kjo gjë nuk ka ndodhur por edhe pse është bërë ndryshimi i sistemit përsëri elita apo klasa politike mbeti po e njëjta, ajo e sistemit komunist.

Arritja tek zgjedhësi

Një faktor që ka ndikuar është edhe fushata që këto parti të arrijnë ta realizojnë në zgjedhje kur marrin pjesë dhe hapësira territoriale e shtrirjes së tyre. Botimet mbi vendet komuniste kanë treguar se për sa i përket anëtarësisë dhe shtrirjes territoriale ka një dallim midis partive trashëgimtare të partive komuniste dhe partive të reja duke anuar balanca nga të parat, (Xhaferraj, 2018). Kjo i detyrohet faktit që partitë pasuese të partisë komuniste trashëguan anëtarësinë dhe shtrirjen territoriale të partisë mëmë, duke i vendosur thellësisht në disavantazh partitë opozitare (Van Biezen, 2003). Partia Socialiste që në gjenezën e saj i kishte strukturat, institucionet, zyrat dhe shtrirjen territoriale gati sepse e trashëgoi këtë nga paraardhësit e saj. Duke i pasur këto elementë të dhënë tashmë gati, për atë shtrirja territorial nuk ishte një problem i madh. Këtë problem e pati dhe Partia Demokratike në fillesa e saj, e cila nuk kishte asgjë gati, nuk kishte as strukturat, nuk kishte as shtrirjen gjeografike në Shqipëri e aq më pak anëtarësi partiake por duhet të strukturonte dhe të organizonte gjithçka nga hiçi.

Me kalimin e viteve ajo arriti të ndërtonte gjithçka kishte të nevojshme dhe të kishte suksese në politikën shqiptare. Në vitet e tranzicionit, deri në ditët e sotme edhe partitë e reja kanë hasur në po të njëjtin problem, në mungesën e anëtarësisë që ka vlerë dhe është kontribuuese në suksesin e një partie por edhe në mungesën e shtrirjes gjeografike. Mungesa e burimeve financiare në krahasim me partitë e mëdha, për partitë e vogla ka qenë pengesa kryesore e tyre për të pasur një shtrirje të gjerë gjeografike. Rrjedhimisht kuptohet që kur nuk ke një shtrirje të konsiderueshme territoriale atëherë kuptohet që elektorati yt zgjedhës do të jetë shumë i ulët dhe shumë i pamjaftueshëm për të mbledhur votat e nevojshme për të mbijetuar në sistemin partiak. Këtu pastaj ka një rëndësi të veçantë edhe financimi i partive politike.

Në ndryshimet e bëra në ligjin mbi financimin e partive politike në Shqipëri, në vitin 2000 vendosën që për veprimtarinë vjetore të partive politike, 70% e ndihmave shtetërore do të ndahej në përputhje me votat e fituara, pavarësisht nëse ka vend në Kuvend, 20% në mënyrë të barabartë mes partish që kanë marrë grup parlamentar, 10% në mënyrë të barabartë mes partish që kanë marrë pjesë në dy zgjedhjet e fundit parlamentare me lista kombëtare. Ndërsa sigurisht që kur bëhet fjalë për financimin e fushatave elektorale sasia e fondit është në bazë të rezultateve të

fushatës pararendëse. E kur kjo nuk rezulton e suksesshme për partitë e vogla, kjo jep ndikimin në ekzistencën e saj.

Mungesa e vizionit, ideve, vlerave dhe kauzave

Në mosesin e partive të reja një ndikim të forta e ka pasur edhe mungesa e vizionit, vlerave, ideve, apo dhe kauzave të këtyre partive që kanë arritur të formohen por që nuk e kanë pasur jetën e gjatë në sistemin partiak. Po të analizosh historinë e sistemit partiak në Shqipëri dhe arsyet se përse janë formuar apo kanë lindur partitë e vogla, ajo është e lidhur ngushtë përsëri me partitë që janë forca kryesore. Pothuajse të gjitha ato parti të reja që janë formuar kanë lindur si ndarje apo fragmente brenda këtyre partive. Në momentin që brenda PD-së apo PS-së ka pasur individ apo grupe të pakënaqur me partinë brenda të cilës ndodheshin ato menjëherë kanë dalë fillimisht si ndarje më vete dhe më pas kanë formuar partitë e tyre.

Këto parti asnjëherë nuk janë përpjekur të përfaqësojnë ndonjë grup të veçantë që kanë nevojë për përfaqësim por thjesht janë mjaftuar me justifikim që janë parti anti-sistem kur në fakt ato rrjedhin nga vetë po ky sistem. Që të funksionojë ajo duhet të ketë një komunitet të cilin e përfaqëson, duhet të ketë një vizion ndryshe, programe të qarta politike që sjellin ndryshim e që rrisin besueshmërinë tek zgjedhësit shqiptarë, por për fatin tonë të keq kjo partive të reja ju ka munguar dhe sigurisht që mosesi i tyre ka qenë i ditur.

Pragu elektoral i lartë?

Së fundmi, por jo më pak i rëndësishmi, në mendimin tim ai që ka ushtruar një ndikim të madh në suksesin dhe jetëgjatësinë e partive të reja politike në Shqipëri ka qenë dhe vazhdon të jetë padyshim pragu elektoral i zgjedhjeve. Duke ekzistuar ky prag elektoral kufizues zgjedhjet në shumicën e rasteve kanë qenë jo të frytshme për partitë e vogla, e për pasojë shumica kanë pushuar së ekzistuari.

Pra, këto parti lindin, konkurrojnë në një palë zgjedhje, humbin dhe menjëherë ato shpërbëhen duke pushuar së ekzistuari dhe kjo ka ndodhur me të gjitha partitë e reja që kanë lindur në sistemin partiak në Shqipëri. Pra dëshira vetëm për të fituar pushtet dhe kjo për të qenë ndikues në të ardhmen ka bërë që këto parti të shuhen. Pra për ta përmbledhur të gjithën, duke marrë në konsideratë arsyet e trajtuara më sipër mund të kuptojmë përse jetëgjatësia e partive të reja në sistemin partiak në Shqipëri ka qenë jetëshkurtër. Ajo që mund të them dhe mund të rekomandoja do të ishte sigurisht, të kemi parti të reja, me ide, vizion dhe idealin e përfaqësimit ta kenë më të fortë se etjen për të pasur pushtet.

I. BIBLIOGRAFIA

- 1- Xhaferraj, A. (2018) *Sistemi Partiak Në Shqipëri, Organizimi partiak- Anëtarësia*, Tiranë: UET Press, pg 76-77.
- 2- Xhaferraj, A. (2018) *Sistemi Partiak Në Shqipëri, Korniza ligjore e financimit të partive politike në Shqipëri*, Tiranë: UET Press, pg 109.
- 3- Lipset, S. M. & Rokhan, S. (1976) *Party Systems and Voter Alignments*, New York: The Free Press, pg 63.
- 4- Van Biezen, I. (2003) *Political Parties in New Democracies, Party Organization*, Hampshire.
- 5- Ylli Bufi, "Tempulli i Demokracisë", Ombra GVG, Tiranë, 2010.